

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Ardian DVORANI	- Kryesues
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar
Arjana FULLANI	- Anëtar
Andi ÇELIKU	- Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 28.02.2017 dhe të datës 01.03.2017, mori në shqyrtim çështjen administrative me nr. 03132/2014 akti, që u përket palëve:

PADITËS: Dashnor Spahiu

PALË E PADITUR: Ministria e Arsimit dhe Sportit

OBJEKTI: Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, Vendim nr. 4218/1, datë 26.08.2013 të Drejtorit të Drejtorisë Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj paditësit z. Dashnor Spahiu si të pabazuar në ligj dhe prova. Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, Vendim nr. 669, datë 08.11.2013 të Drejtorit të Drejtorisë Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për dhënien e masës disiplinore “Lirim nga Shërbimi Civil” ndaj paditësit z. Dashnor Spahiu si të pabazuar në ligj dhe prova. Kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës që nga moment i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës deri në kthimin në punë si Inspektor në Drejtorin e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës .

BAZA LIGJORE: Neni 153 e vijues i K.Pr.Civile, neni 2 pika 8, neni 25 Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, neni 115/a, 116/c dhe 117/1 i Kodit të Procedurës Administrative, neni 15 i ligjit Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 134, datë 20.01.2014, ka vendosur:

-Pranimin e padisë.

-Shfuqizimin e akteve administrativ, vendimit nr. 4218/1, datë 26.08.2013 për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhe vendimit nr. 669, datë 08.11.2013 të Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për dhënien e masës disiplinore “Lirim nga Shërbimi Civil” për paditësin Dashnor Spahiu.

-Kthimin në vendin e mëparshëm të punës së paditësit, si auditues pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Detyrimi e palës së paditur për të shpërblyer financiarisht paditësin, për të gjithë kohën e qëndrimit pa punë deri në rikthimin në detyrë. Rrëzimin e kërimit për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 602, datë 11.03.2014, ka vendosur:

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 134, datë 20.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit...

-Pranimin e padisë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë:

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 602, datë 11.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Tiranë, më 01.03.2017

Nr. 31001-03132-00-2014 i Regj. Themeltar

Nr. 00-2017-212 i Vendimit (110)